

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**

Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU " Hidrodrini " Sh. A. Pejë "KRU " Hidrodrini " Sh. A.- Pejë, publikon këtë :

K O N K U R S

Pozita : Menaxher/re I ITUZ në Pejë

Ekzekutues: 1 (Një).

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 mujore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Nën mbikëqyerjen e Drejtorit Teknik dhe KE

Detyrat e Menaxherit/së:

Bashkëpunon me :

- Drejtorin Teknik
- Të gjitha departamentet tjera
- Personelin e Impiantit për Trajtim të Ujërave të Ndotura (ITUN)

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Menaxhimi i proceseve mekanike dhe biologjike në ITUN, duke përfshirë trajtimin e llumit
- Menaxhimi i stafit
- Mbatja e trajnimeve mbi shëndetin dhe sigurinë në punë
- Garantimi që të gjitha të dhënat relevante (konsumi i energjisë, koha e punës së pompave, kostot, dëmtimet, pengesat, zëvendësimet e nevojshme, etj) të jenë evidentuar siç duhet
- Mirëmbajtja dhe planifikimi
- Planifikimi furnizimit me materiale dhe kemikate
- Koordinimi me stafin sipas rrethanave në ITUN (operim veror dhe dimëror, pengesat e paraqitura në të njëjtën kohë)
- Përgatitja e planeve vjetore
- Përgatitja e formularëve të nevojshëm për punë të mirembajtjes

Aftësitë dhe kompetencat kyçe :

- Posedim i diplomës universitare në inxhinieri Hidroteknike
- Përvojë në trajtimin mekanik dhe biologjik të ujërave të ndotura
- Aftësi të mira në komunikim dhe negociim
- Aftësi në menaxhimin e punës ekipore
- Aftësi në planifikim dhe konceptim
- Aftësi të forta organizative
- Njohja e gjuhës Angleze.

Procedurat për aplikim :

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin për punësim dhe të njëjtit t'ia bashkangjitin këto dokumenta :

- Diplomë e Universitare
- Biografinë (CV) e detajuar;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime;
- Dëshmi mbi prevojen e punës në lemin e ITUZ.
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel Auto cad).

❖ *Aplikacionet mund të merren në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr " Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web – faqen " Hidrodrini" Sh. A. www.hidrodrini.com.*

❖ *Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU " Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. " Lekë Dukagjini" nr.156 – Pejë. (Shpallja do të jetë e hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web – faqen www.hidrodrini.com*

❖ *Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale përverifikim para komisionit intervistues.*

❖ *Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.*

❖ *Aplikacionet e derguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen, KRU " Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.*